

STATUTI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"Mare Sherbime Hoteleri & Turizmi,, SH.P.K

KREU - 1

THEMELIMI-EMRI-OBJEKTI-KOHEZGJATJA –SELIA

Neni-1 -Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit

1-Sot, me dt 31-05-2021 ne , themeluesit, mbeshtetur me ligjin 9901 dt 14-04-2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite tregetare,, kemi krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin "Mare Sherbime Hoteleri & Turizmi,, Sh.p.k (ketej e tutje "shoqeria,,) si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar qe do te rregullohet nga ky statut si dhe nga legjislacioni Shqiptar ne fuqi.

2- Themeluesit e shoqerise jane:

a- z.Stelio Bollano atesia Leandro, lindur me 19.02.1981 ne Tirane , banues ne Himare , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i Pasaportes me numer I10219045R

b- z.Andrea Bollano atesia Leandro, lindur me 15.05.1985 ne Tirane , banues ne Himare , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i dokumentit te identifikimit me numer I50515065B

Neni-2 – Objekti

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte:

- Struktura akomoduese
- Bar Restorant
- Stacione plazhi
- Vendbazim per mjetet ujore, motorrike dhe jo motorrike

Neni-3 -Kohezgjatja

Kohezgjatja e veprimtarise do te jete pa afat nga momenti i nenshkrimit te ketij statuti.

Neni-4: Selia e shoqerise

1-Selia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Mare Sherbime Hoteleri & Turizmi,, SH.P.K do te jete ne adresen: Rruga e Kaoneve 19, Potam, Himare

2-Adresa e shoqerise per qellime komunikimi elektronik eshte si vijon: contact@himarahotel.com

KREU – 2

KAPITALI

Neni-5: Kapitali themeltar

1-Kapitali themeltar fillestar i Shoqerise eshte 100.000 (njqinde mije) leke dhe eshte i perbere nga 2 kuota.

Pjesmarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:

- a-Ortaku themelues z.Stelio Bollano : Zotrues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 50.000 leke qe perben 50% te kapitalit te shoqerise
- b-Ortaku themelues z.Andrea Bollano : Zotrues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 50.000 leke qe perben 50% te kapitalit te shoqerise

2-Kapitali i ortakeve eshte ne para dhe shlyer plotesisht nga ortaket e shoqerise.

Neni-6 Zmadhimi dhe zvogelimi i Kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapiatalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e-ortakeve , e cila merr vendim ne te njejta kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 7- Transferimi i kapitalit

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes. Shitja e kuotave (pjeserisht ose në teresi) jashtë rrethit të ortakeve mund të bëhet vetëm nëse ortaket me unanimitet shprehën dakort duke e deklaruar me shkrim.
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Pjeset e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme ndërmjet ortakeve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjeset e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme në rruge trashëgimie.

KREU-3

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni-8 Organi Vendimarrës

Asambleja e ortakeve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.

Asambleja e ortakeve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- ç) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asambletë të përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakeve në asambletë të përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë të përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni-9 Menyrat e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakeve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortaket janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni – 10 Kuorumi

1. Në rastin e çështjeve, që vendosen me shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortaket me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Kur asambleja duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë tregëtare,, ajo mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse ortaket, që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni – 11 Marrja e vendimeve

1-Asambleja e përgjithshme vendos me **tri të katërtat** e votave të zotrueseve të kapitalit , të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

2-Asambleja e përgjithshme vendos **me shumicën e votave** të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni – 12 Përfshirja nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

NENI-13 Administrimi

Administrator i Shoqërisë do të jetë z. Stelio Bollano , afati i emerimit është 5 vjet me të drejtë riperteritjeje. Emerimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit.

Neni-14 Kompetencat e administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme ;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarrëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) Raportojnë përpara Asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vecante për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.
- f) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblesë të përgjithshme në rastet kur:

- Sipas bilanci vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda tre muajve në vazhdim.

- Shoqëria propozon të shes apo të disponojë në mënyrë tjetër aktivitetet, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

- Shoqëria, brenda dy viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasurine, që kanë vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë , që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Neni-15 Përgjegjësit e administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë dhe ndaj të tjerëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo fajet e kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshje, per te perballuar ne menyre individuale ose solidare sipas rastit pasojat perkatese.

Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per tregtetaret dhe shoqerite tregetare" administratorët detyrohen:

- a) te kryejne detyrat e tyre te percaktuara ne ligj ose ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;
- b) te ushtrojne kompetencat qe u njihen ne ligj ose ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
- c) te vleresojne me pergjegjesi cheshtjet, per te cilat merret vendim;
- ç) te parandalojne dhe menjanojne rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;
- d) te ushtrojne detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

2. Administratorët, gjate kryerjes se detyrave te tyre, pergjigjen ndaj shoqerise per çdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

3. Nese administratorët veprojne ne kundershtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, jane te detyruar t'i demshperblejne shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojne çdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët janë të detyruar t'i demshperblejne shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundershtim me dispozitat e ketij ligji, kryejne veprimet e meposhtme:

- a) u kthejne ortakëve kontributet;
- b) u paguajne ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shperndajne aktivet shoqerise;
- ç) lejojne qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftësi paguese per te shlyer detyrimet;
- d) japin kredi.

Pervec padise per shlyrjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit.

Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyrjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

KREU-4

VITI FINANCIAR DHE EKSPERTET

Neni-16 Viti financiar

Viti financiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Q.K.B dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni- 17 Ekspertet

Eksperti (ekonomisti i punesuar ose kontabilist i kontraktuar) ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregetare te shoqerise, ate gjithevjetore dhe ate ne lidhje me kontrollat periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollat periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoj ne kohe ortakëve per ti shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

neni -18 Shperndarja e fitimeve

1. Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne statut, ortakët kanë të drejtë të ndajne pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqerise.

2. Me perjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, fitimi u shperndahet ortakëve në raport me kuotat e zoteruara.

3-Shoqeria mund t'u shperndaje fitime ortakëve, vetem nese pas pagimit te dividendit:

- a) aktivet e shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e saj;
- b) shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve ne vazhdim.

4-Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 3 të këtij neni, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.

5-Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.

KREU - 5 PRISHJA –RIORGANIZIMI I SHOQERISE

Neni – 19 Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- 1- kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- 2- me vendim të asamblese së ortakëve;
- 3- me hapjen e procedurave të falimentimit;
- 4- nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";
- 5-me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoqëri në likuidim e siper"

Prishja e shoqërisë tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund të drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni – 20 Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblese së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të ligjit 9901 dt 14-04-2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare"

Neni – 21 Baza ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjisllacionit Shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" , Kodin civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 22 Mosmarreveshjet

Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Ortakët

I Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar

"Mare Sherbime Hoteleri & Turizmi,, Sh.p.k

STELIO BOLLANO



ANDREA BOLLANO

